

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
 ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI

Nr/Br. 1148/20
 Datë/Datum. 24.12.20

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Korporata Energjetike e Kosovës**

Nr i prokurimit	KEK-20-5944-2-2-1
Nr i brendshëm	KEKO-20-322-221

Sa i përket tenderit për: **Hartimi i planit për krijimin e sistemit të integruar për menaxhimin e vajrave industrial dhe mbeturinave të ngurta në të gjitha repartet**

ANKESË

Identifikimi i ankuesit*

Emri i Kompanisë: **"KIWER Consulting" Sh.P.K.**

Adresa : **Rr. Shaqir Igrishita, Mati 1, A 11, Hy-08, Nr. 34**

Numri Telefonit mobil : **044-159-456**

Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj: **Ramiz Kokollari**

Adresa elektronike: **ramiz.kokollari@gmail.com**

Data e parashtrimit të ankesës: **24.12.2020**

Nënshkrimi dhe vula: _____



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

1. Njoftimi për kontratë: 01.10.2020
2. Formulari Standard për korrigjimin e gabimeve në Njoftimet e Publikuara- 27.10.2020
3. Afati për dorëzim të tenderit: 09.11.2020
4. Procesverbali i hapjes së Ofertave: 09.11.2020
5. Kriteri i vlerësimit të ofertave : Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët;
6. Njoftimi për dhënie të kontratës/vendimi i AK : 10.12.2020
7. Njoftimi për eliminim: 10.12.2020
8. Kërkesa për Rishqyrtim – 15.12.2020
9. Vendimi i AK për Refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim: 16.12.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po					Jo	X	
----	--	--	--	--	----	---	--

Hapja në mënyrë elektronike- Nuk kemi marrë pjesë

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	X				Jo		
----	---	--	--	--	----	--	--

Itën 10.12.2020 përmes Platformës së e- Prokurimit, nga Autoriteti Kontraktues kemi ar Letër standarde për tenderuesin e eliminuar.

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☒

Jo

☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së.

Me datën 15.12.2020 përmes platformës së e-prokurimit kemi dërguar Kërkesën për Rishqyrtim të Autoriteti Kontraktues – Korporata Energjetike e Kosovës . Me datën 16.12.2020 përmes platformës së E-prokurimit kemi pranuar përgjigjeje – Vendimin nga Autoriteti Kontraktues për refuzim të kërkesës për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti Kontraktues – Korporata Energjetike e Kosovës, gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës , Ligji Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05//L-092, duke shkelur këto dispozita ligjore:

Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

**** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.**

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues - Korporata Energjetike e Kosovës ka bërë publikimin e Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe Letrat Standarde për Tenderuesit e Eliminuar dhe Letrën Standarde për Tenderuesin e Suksesshëm, në Platformën e E-Prokurimit me datën 10.12.2020.

Me datën 11.12.2020 kemi bërë kërkesë për qasje në dokumente të tenderit dhe Autoriteti Kontraktues, me datën 14.12.2020, na ka lejuar qasje në dokumentet e tenderit.

Në Letrën Standarde për Tenderuesin e eliminuar që kemi pranuar nga Autoriteti Kontraktues, si arsyeje e eliminimit të kompanisë tonë është shënuar se kinse Referencat e prezantuara nga kompania e jone nuk janë të ngjashme me natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit. Autoriteti Kontraktues pa dhënë asnjë arsyeje se pse këto referenca nuk janë të ngjashme me natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit na eliminon vetëm me një gjysmë fjali të vetme.

Arsyeja e eliminimit të kompanisë tone të shënuar në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar nuk qëndrojnë për këto arsyeje:

- Kërkesa në dosje të tenderit ka qene : Operatori Ekonomik duhet të prezantojë së paku 3 (tri) referenca apo certifikat mbi përfundimin e punëve nga punëdhënësi mbi implementimin e suksesshëm të projekteve të ngjashme për tri vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë. Fjalja **“projekteve të ngjashme”** nuk nënkupton që **100 %** duhet me qene sikur në titullin e aktivitetit të prokurimit: **“Hartimi i planit për krijimin e sistemit të integruar për menaxhimin e vajrave industrial dhe mbeturinave të ngurta në të gjitha repartet”**;
- Kompania jone së bashku me ofertën ka dorëzuar Referenca që dëshmojnë së ka kryer shërbime që kanë të bëjnë me hartimin e planeve të menaxhimin e trajtimit të mbeturinave.

Relevanca e referencave të kompanisë tone - “KIWER Consulting” SH.P.K

- Referenca No. 1: Kadastr i mbeturinave të rrezikshme dhe kimikateve - Projekti i zhvillimit të kadastrit është zbatuar nga **KIWER Consulting shpk**, për Agjencine e Mbrojtjes së Mjedisit. Kadastr i mundëson raportimin e mbeturinave dhe kimikateve të rrezikshme nga prodhuesit, zotëruesit, transportuesit dhe operatorët tjerë të licencuar të mbeturinave në harmoni me infrastrukturen ligjore sa vijon: Ligjin e mbeturinave 04-L-060, ligji 04_L-197 për kimikate, EU Waste Framework Directive 2008/98, Udhëzimi Administrativ 2013/13 Katalogu shtetëror i mbeturinave, UA_2014/17 për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e mbeturinave dhe kimikateve të rrezikshme, UA 2017/18 për listën teknike të sigurisë, UA 2014/25 për mbeturinat nga pajisjet WEEE, UA 2013/05 për vavra mbeturine, UA 2014/26 menaxhimi i baterive dhe akumulatorëve mbeturine, UA 2015/07 menaxhimi i mbeturinave të ndërtim demolimit, UA 2015/22 menaxhimi i mbeturinave që përmbajnë azbest, UA 2017/14 menaxhimi i mbeturinave që përmbajnë PCB, PC dhe ndotës tjerë të qëndrueshëm organik, CLP EU Directive 1272/2008, COMMISSION REGULATION (EU) No 849/2010 on waste statistics, EC regulation 1907/2006 REACH. **Mbeturinat dhe kimikatet e rrezikshme të KEK, Trepçës, Feroniklit, Sharrcem dhe operatorëve tjerë për 2019 janë futur në këtë kaster dhe do vazhdojnë të raportohen dhe futen në baze vjetore siç kërkohet me kornizën ligjore të lartcekur.**

- **Referenca No.2:** Zhvillimi i formave të raportimit dhe udhëzuesit teknik për nevojat të Ministrisë së Ambientit, AMMK dhe aktereve tjerë për të mbajtur sistemin e menaxhimit të mbeturinave. **KIWER Consulting shpk** ka implementuar projektin e financuar nga GIZ , ku ka zhvilluar kornizën raportuese për Agjencionin e Mbrojtjes së Mjedisit përmes së cilës prodhuesit, zotëruesit, transportuesit dhe operatorët tjerë të licencuar të mbeturinave do të raportojnë mbeturinat e tyre përfshi **KEK-un, Trepçën dhe operatorët tjerë**. Ky sistem raportues është bere në harmoni me kërkesat ligjore si: Ligji i mbeturinave 04-L-060, UA 2013/13 Katalogu shtetëror i mbeturinave, UA_2014/17 për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e mbeturinave dhe kimikateve të rrezikshme, Rregullorja (EU) No 849/2010 për statistika të mbeturinave, UA 2014/25 për mbeturinat nga pajisjet WEEE, UA 2013/05 për vavra mbeturine, UA 2014/26 në menaxhimin e baterive dhe akumulatoreve mbeturine, UA 2015/07 menaxhimi i mbeturinave të ndërtim demolimit, UA 2015/22 menaxhimi i mbeturinave që përmbajnë azbest, UA 2017/14 menaxhimi i mbeturinave që përmbajnë PCB, PC dhe ndotës tjerë të qëndrueshëm organik, CLP EU Directive 1272/2008, COMMISSION REGULATION (EU) No 849/2010 on waste statistics, EC regulation 1907/2006 REACH. **KEK, Trepça dhe obliguesit tjerë ligjor do të përdorin këtë sistem informues të menaxhimit të mbeturinave për të raportuar mbeturinat e tyre të AMMK.**
- **Referenca No.4:** Hartimi i planeve të menaxhimit të mbeturinave për komunat Ferizaj, Mitrovicë, Kline, Istog, Shtime, Deçan, Kamenice, Novobërdë, Zveçan, Zubin Potok, Leposaviq dhe Mitrovicë e Veriut. Komunat sipas Nenit 10 dhe Nenit 15 janë të detyruara të hartojnë planet komunale për menaxhimin e mbeturinave në komunat e tyre. **KIWER Consulting** ka kryer në bashkëpunim me komunat e lartcekura, **planet komunale. Në një pjesë të këtyre komunave ka aktivitete dhe mbeturina industriale, në disa tjera ekzistojnë hotspote mjedisore nga periudhat e kaluara çka e shton relevancën e projektit.** Planet komunale të menaxhimit të mbeturinave të zhvilluara nga projekti përmbajnë analizën e sistemeve ekzistuese të menaxhimit të mbeturinave, hartimin e planeve operative, caktimin e objektivave, hartimin e planeve investive, futjen e principeve të ekonomisë qarkore, zhvillimin e planeve financiare dhe planeve të veprimit dhe monitorimit me tregues të suksesit. Konkretisht komunat e Mitrovicës, Mitrovicës së Veriut, Zveçanit, Leposaviqit dhe Novobërdës, janë udhëzuar përmes planit së ti **menaxhojnë mbeturinat e tyre minerare dhe industriale** në harmoni me kuadrin ligjor dhe mënyrën që mbron shëndetin e njeriut dhe mjedisin.
- **Referenca No.3:** Mbështetja e komunave Zveçan, Zubin Potok, Mitrovicë e Veriut dhe Leposaviq në selektimin e modelit operativ të menaxhimit të deponisë Savina Stena (Zveçan). Ky projekt i zbatuar nga **KIWER Consulting** dhe financuar nga Zyra e BE-së dhe GIZ ka përfshi ndërmjet tjerash analizat ligjore dhe teknike të përzgjedhjes së modelit optimal të operimit të deponisë si dhe kalkulimin e kostove të operimit dhe të mirëmbajtjes së deponisë që përfshin ndërmjet tjerash operimin, riciklimin dhe trajtimin e mbeturinave, pajtueshmërinë mjedisore, investimet kapitale dhe përcaktimin e tarifave të shërbimit.

- **Referenca No. 5.** Mbështetja e komunave në zbatimin e procesit të caktimit të tarifave të grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave për komunat Ferizaj, Mitrovice, Vushtrri, Skenderaj, Deçan, Fushe Kosove, Podujeve, Lipjan, Graçanice Mitrovice e Veriut, Zveçan dhe Leposaviq. KIWER ne bashkëpunim me komunat e lartcekura ka zhvilluar procesin e caktimit të tarifave për shërbimin e grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave për komunat e lartcekura siç kërkohet me Nenin 15 të Ligjit të Mbeturinave. Procesi tarifor konsiston në zhvillimin e skenarit të gjenerimit të mbeturinave sipas llojeve, aktiviteteve të riciklimit, operimit dhe mirëmbajtjes, efikasitetit të operimeve, planeve investive, respektimit të standardeve mjedisore e kështu me radhe. Edhe plani i KEK-ut i menaxhimit të mbeturinave duhet të zhvillohet në mënyrën që i integron këto aspekte duke siguruar kosto optimale të operimit dhe mirëmbajtjes, respektimin e standardeve mjedisore, futjen e principeve të ekonomisë qarkore, ripërtëritjen e bazës së aseteve të menaxhimit të mbeturinave dhe përfundimisht përmirësimin e qëndrueshmërisë së sistemit.
- **Referenca No 6:** Studimi i potencialit të skemës Deposit Refund System për tu implementuar në Kosovë. Ky projekt është zbatuar nga **Eunomia dhe KIWER Consulting** për Ministrinë e Ambientit me qëllim të futjes së sistemit të riciklimit të mbeturinave nga plastika, metali dhe materiale tjera ricikluese. Ky projekt është vlerësuar dhe miratuar nga Ministria e Ambientit dhe pritët implementimi i shpejte i ti.

Nga këto të dhëna të shënuara me larte shume qarte shihet së referencat që i kemi dorëzuar së bashku me ofertën, jo vetëm që i plotësojnë kërkesat e AK por edhe i tejkalojnë ato. As kush ma mire së Ekspertët Vendor nuk e njohin Legjislacionin e aplikueshëm që rregullon qeshjet e planifikimit, trajtimit, monitorimit, dhe menaxhimit të mbeturinave në Republikën e Kosovës.

Nëse Autoriteti Kontraktues konsideron së kryerja e shërbimeve të ngjashme në Institucionet e Republikës së Kosovës është e pa pranueshme për zyrtaret e KEK-ut, dhe së të pranueshme janë vetëm shërbimet që janë kryer në Institucionet e Republikës së Serbisë, atëherë këtë kriter diskriminues ka mundur ta vendos në Dosje të Tenderit, e jo tani në heshtje ta përdorë si kriter të vlerësimit të ofertave.

Nga dokumentacioni i ofertave të Operatoreve Ekonomik që kemi pasur qasje , konsiderojmë së Autoriteti Kontraktues - Korporata Energjetike e Kosovës , vlerësimin e ofertave nuk e ka bere në harmoni me nenin 59 të LPP, pasi që ka shpërblyer me kontrate Grupin e OE: "THE Cuban" SHPK & "Institut za Rudarsvo i Metalurgiju", Bor & "ECOLOGY PARTNERS" DOO, të cilët nuk kane arritur që ti plotësojnë të gjitha kërkesat e kërkuara nga AK.

Edhe pse gjate sqarimeve të tenderit AK, ka bere ndryshimin- plotësimin e kriterit, neni 9.2 pika 3 e FDT - Dy (2)- Ekspertë të licencuar për trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe vajrave mbeturinë dhe ka bere plotësimin e këtij kriteri sipas kërkesës dhe udhëzimeve të Grupit të OE që tani e ka shpërblyer me kontrate, parape Grupi i OE: "THE Cuban" SHPK & "Institut za Rudarsvo i Metalurgiju", Bor & "ECOLOGY PARTNERS" DOO, prape ky grup i OE , nuk ka arritur ta plotësojë këtë kriter:

Eksperti 1. Z. Novica Stankovic – është doktor i shkencave të Kimisë, por nuk ka asnjë dokument që dëshmon se ka **përvojë pune në trajtimin e mbetjeve në miniera dhe termocentrale**, ashtu siç janë kërkuar nga AK në nenin 9.2 pika 3 e FDT.

Z. Stankovic nuk është Ekspertë i licencuar për trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe vajrave mbeturinë. Titulli, Doktor Shkence është titull shkencor me i larte se sa titulli Master në inxhinieri, ashtu siç e ka kërkuar Autoriteti Kontraktues , por diploma e doktoraturës nuk mund ta zëvendësoj Licencën e Ekspertit të cilën vete AK e ka kërkuar.

Nga CV e z. Stankovic, shihet se e tere eksperience e tij e punës është në menaxhimin e ndërmarrjeve të ndryshme dhe në Institucione Arsimore të Republikës së Serbisë. Nuk ka asnjë dite eksperience të punës në miniera dhe në termocentrale ashtu siç e ka kërkuar AK.

Eksperti 1: znj. Radmila Markovic – është doktor i shkencave të Teknologjisë Kimike, por nuk ka asnjë dokument që dëshmon se ka **përvojë pune në trajtimin e mbetjeve në termocentrale**, ashtu siç janë kërkuar nga AK në nenin 9.2 pika 3 e FDT.

Znj. Markovic nuk është Ekspertë e licencuar për trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe vajrave mbeturinë. Titulli, Doktor Shkence është titull shkencor me i larte se sa titulli Master në inxhinieri, ashtu siç e ka kërkuar Autoriteti Kontraktues , por diploma e doktoraturës nuk mund ta zëvendësoj Licencën e Ekspertit të cilën vete AK e ka kërkuar.

Nga CV e znj. Markovic shihet se e tere eksperience e saj është në Institutin Xeharo Metalurgjik në Bor dhe në **Institucione Arsimore të Republikës së Serbisë**. Nuk ka asnjë dite eksperience të punës në termocentrale ashtu siç e ka kërkuar AK.

Është shume shqetësuese që Autoriteti Kontraktues- Korporata Energjetike e Kosovës një projekt kaq të rëndësishëm për përmirësimin dhe ruajtjen e ambientit ti besoj një Grupi të OE të cilët nuk kane dëshmuar se kane kapacitete dhe eksperience për kryerjen me sukses të këtyre shërbimeve. Lideri i grupit, "THE Cuban" SHPK nga Prishtina me numër të regjistrimit 810803595, nuk e ka të regjistruar fare veprimtarinë për kryerjen e këtyre shërbimeve në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve dhe nuk ka asnjë kapacitet për kryerjen e këtyre shërbimeve.

Së Autoriteti Kontraktues gjate zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka bere shkelje substanciale të nenit 7 të LPP duke i përshtat kriteret një OE të preferuar, e dëshmojnë edhe këto fakte:

Përmes kërkesës për sqarime shtese, ka pranuar që ti ndryshoni kriteret e kërkuara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratës dhe të njëjtat kriteret ti përshtate sipas kërkesës (sugjerimeve) të Grupit të OE, "THE Cuban" SHPK & "Institut za Rudarsvo i Metalurgiju", Bor & "ECOLOGY PARTNERS" DOO, të cilin grup të OE tani ka shpërblyer me kontrate.

Në Dosje të Tenderit në nenin 9.1 & 9.2 pika 3 - Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), ka shënuar: Dy (2)- ekspertë të licencuar për trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe vajrave mbeturinë. Ekspertët duhet të jetë ekspert të lamisë sipas normave të EU apo ekuivalent me normat e EU dhe të ketë së paku 5 (pesë) vite përvojë pune në trajtimin e mbetjeve në miniera dhe termocentrale. Eksperti duhet të ketë Diplomë Master në inxhinieri, të dëshmohet me kopje të diplomës.

Me datën 07.10.2020, pas kërkesës së OE ka publikuar këto sqarime:

Pyetja e OE "ALBO GROUP" SHPK:

- *Ekspertë të licencuar për trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe vajrave mbeturinë, në Kosovë nuk ka ekspert të licencuar të tillë kjo është diskriminuese për shumë OE.*
- *Kërkojmë sqarim se çka nënkupton sipas normave të EU apo ekuivalent me normat e EU?*

Përgjigjja e AK

- Kriteret e vendosura ne specifikim nuk mendoj qe janë diskriminuese, pasi qe nëse nuk ka ekspert të licencuar në Kosove, OE mund të angazhojnë ekspert të jashtëm të licencuar. Qëllimi është që hartimi i planit për krijimin e sistemit të integruar për menaxhimin e vajrave industrial dhe mbeturinave të ngurta në të gjitha repartet, të jete profesional dhe i zbatueshëm.
- Ekspert sipas normave te EU nënkupton që :
 - Ekspertet te jenë Specialist të Lartë të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta me fokus në praktikat dhe përvojën e menaxhimit të mbetjeve sipas direktivave te BE
 - Eksperti duhet te ketë Diplomë Master në inxhinieri, shkenca mjedisore, gjeologji ose në fushë tjetër përkatëse, të ketë së paku 5 (pesë) vite përvojë pune në trajtimin e mbetjeve në miniera dhe termocentrale dhe përvojë vendore ose ndërkombëtare në fushën e menaxhimit të mbeturinave nga vendet në BE, Kosovë apo regjion.
 - Ekspertet duhet te kenë përvojë praktike, të thelluar në të paktën në një nën-fushë të menaxhimit të mbetjeve, njohje te shkëlqyeshme me direktivat mjedisore të BE-

së dhe legjislaturën lidhur me mbeturinat, përvojë të mëparshme në ofrimin e programeve të trajnimit dhe ndërtimit të kapaciteteve .

Pasi që Operatori Ekonomik **"ALBO GROUP" SHPK** nuk ka qene i kënaqur me përgjigjeje e dhëne nga ana e AK, me datën 22.10.2020 ka dërguar të AK - Kërkesën për Rishqyrtim. Autoritet Kontraktues në përgjigjeje e refuzimit të Kërkesës për Rishqyrtim të datës 26.10.2020 keni shënuar:

Në kërkesën për rishqyrtim para hapjes OE pretendon se Kërkesat mbi mundësitë teknike:

" Dy (2) ekspertë të licencuar për trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe vajrave mbeturinë. Ekspertët duhet të jetë ekspert të lamisë sipas normave të EU apo ekuivalent me normat e EU dhe të ketë së paku 5 (pesë) vite përvojë pune në trajtimin e mbetjeve në miniera dhe termocentrale Eksperti duhet të ketë Diplomë Master në inxhinieri, të dëshmohet me kopje të diplomes "

janë diskriminuese ,duke konstatuar pa ndonjë fakt relevant se :

" Ekspertë të licencuar për trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe vajrave mbeturinë, në Kosovë dhe as rajon nuk ka ekspert të licencuar të till kjo është diskriminuese, Licenca mund të kërkon që janë shumë adekuatet të Vlersimit të Ndikimit në Mjedisi të cilat i lëshon Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit"

dhe duke na udhëzuar se si të ia përshtasim kërkesat mbi mundësitë teknike atij si OE.Në fakt,në rast se do të pranoni udhëzimet e tij ne do të bënim diskriminim.

Me datën 13.10.2020 pas kërkesës se OE, ka publikuar këto sqarime:

Pyetja 3, dhe udhëzimet e njërit nga anëtarët e Grupit të OE: "THE Cuban" SHPK & "Institut za Rudarsvo i Metalurgiju", Bor & "ECOLOGYPARTNERS" DOO, të cilin grup të OE tani AK e ka shpërblyer me kontrate ka qene:

3. A mund të konsiderohen doktorët e shkencës në fushën e menaxhimit të mbetjeve të ngurta dhe të vajit si një "ekuivalent" i mjaftueshëm për trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe menaxhimin industrial të vajit në pikën 9.2 ku kërkohen prova dokumentare?

Doktorët e shkencës lartëpërmendura kanë diploma universitare, disertacion doktorature në fushën e ekologjisë së aplikuar, çertifikata ADR, çertifikata për burimet e rrezatimit jonizues, etj, përvojë minimale prej 5 vitesh si pedagogë në fakultet dhe në kompani të fushës. A janë doktorët e shkencës e përmendur mësipërm të konsideruar "ekuivalente" të mjaftueshëm për trajtimin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta dhe vajrave industriale?

Përgjigjja e AK:

Po ,doktorët e shkencës në fushën e menaxhimit të mbetjeve të ngurta dhe vajrave, që kanë së paku 5 vite përvojë pune në trajtimin e mbetjeve, mund të konsiderohen ekuivalent me normat e kërkuara.

Nga këto pyetje dhe përgjigjeje shume qarte shihet se si AK e ka ndryshuar dhe përshtatur ketë kriter sipas kërkesës dhe udhëzimeve të Grupit të OE: "THE Cuban" SHPK & "Institut za Rudarsvo i Metalurgiju", Bor & "ECOLOGY PARTNERS" DOO. Ketë e dëshmon edhe fakti se për ta plotësuar ketë kriter, vetëm ky grup i OE ka ofertuar me dy eksperte të cilët e kane qene doktorë të shkencave.

Në rastin e pare gjate refuzimit të Kërkesës për rishqyrtim të OE: "ALBO GROUP" SHPK, AK ka shënuar: " **Ne fakt nëse do të pranohim udhëzimet e tij , në do të bënim diskriminim**".

Ndërsa në rastin e dyte kur ju ka përgjigjur **pyetjeve dhe udhëzimeve** të njërit nga anëtarit të Grupit të OE: "THE Cuban" SHPK & "Institut za Rudarsvo i Metalurgiju", Bor & "ECOLOGY PARTNERS" DOO, në kundërshtim me **nenin 7 te LPP** , ka pranuar që ti ndryshoj dhe përshtatni kriteret sipas **udhëzimeve të këtij Grupi të OE**.

Gjithashtu edhe gjate procesit të vlerësimit të ofertave AK ka bere shkelje substanciale të nenit 7 të LPP, pasi që ofertat nuk i ka trajtuar si të barabarta. Ofertën ton e ka konsideruar si oferte të pa përgjegjshme edhe pse i ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuar nga AK , ndërsa ofertën e Grupit të OE: "THE Cuban" SHPK & "Institut za Rudarsvo i Metalurgiju", Bor & "ECOLOGY PARTNERS" DOO, e ka konsideruar si oferte të përgjegjshme , përkundër faktit se ka pasur devijime substanciale nga kriteret e kërkuara nga AK ne Dosje te Tenderit dhe Njoftimin për Kontrate.

Edhe pse në ketë faze nuk është e mundshme ankimimi në Dosje të Tenderit, por pasi që janë shkelje substanciale po i cekim disa nga këto:

Autoriteti Kontraktues për zhvillimin e këtij aktiviteti të prokurimit në kundërshtim me nenin 27 të LPP dhe nenit 18 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik, ka përdorur **Dosjen e Tenderit për Shërbime (B16)** , ndërsa është dashur që të përdoret **Dosja e Tenderit për Shërbime të Konsulencës (B26)**.

Hartimi i planit për krijimin e sistemit të integruar për menaxhimin e vajrave industrial dhe mbeturinave të ngurta në të gjitha repartet, **nuk është shërbim i thjeshte, (siç janë shërbimet e pastrimit , shërbimet e servisimit të automjeteve , shërbime të ruajtjes së objekteve, etj) ,** por është shërbim i konsulences që kërkon staf shume profesional dhe kriter i vlerësimit nuk mund të jete **Tenderi i përgjegjshme me çmimin me të lire** , por **kriteri ekonomikisht me i favorshëm** duke e përdorur Dosja e Tenderit për Shërbime të Konsulencës (B26) dhe duke i dhëne peshe të pikëve, eksperiencës së kompanisë, përgatitjes profesionale të stafit, eksperiencës së stafit, e kritere tjera të parapara sipas legjislacionit të prokurimit publik për shërbimet e konsulencës .

Autoriteti Kontraktues në Dosje të Tenderit , neni 9.2 pika 3 e FDT, ka kërkuar **dy (2)** ekspertë të licencuar për trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe vajrave mbeturinë, së paku 5 (pesë) vite përvojë pune në trajtimin e mbetjeve në miniera dhe termocentrale dhe ka kërkuar **5 (pesë)**, inxhinier të lemive të ndryshme me se paku 3 vite eksperience. Si dëshmi është kërkuar vetëm kopja e diplomës.

Si ka mundësi që eksperiencia e viteve të punës të dëshmohet vetëm me kopje të diplomës?

Si duket Autoriteti Kontraktues qëllimin kryesor e ka pasur që me kontrate të shpërblej Operatorin Ekonomik, paraprakisht të preferuar dhe jo kryerjen e këtij aktiviteti të prokurimit në mënyre profesionale dhe mundësinë e përzgjedhjes së OE që kane kapacitete profesionale dhe eksperience në kryerjen e këtyre shërbimeve.

Oferta e jone është Oferta e përgjegjshme me çmimin me të lire, prandaj është obligim i Autoritetit Kontraktues që të zbatoj kriterin e dhënies së kontratës për këtë aktivitet të prokurimit , “Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët”, dhe të na shpërblejë me kontrate.

Bazuar në të gjitha të dhënat e shënuara me larte , kërkojmë nga Paneli Shqyrtuese i OSHP-së që kërkesa jonë të aprovohet në tërësi si e bazuar dhe lënda të kthehet në Ri – Vlerësim.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Kompania jone është dëmtuar për shpenzimet e bëra me rastin e përgatitjes dhe dorëzimit të ofertës, shpenzimet e përgatitjes së Kërkesës për Rishqyrtim, shpenzimet e përgatitjes së Ankesës për OSHP dhe fitimet e pritura.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

1. Njoftimi për kontrate: 01.10.2020
2. Formulari Standard për korrigjimin e gabimeve ne Njoftimet e Publikuara- 27.10.2020
3. Procesverbali i hapjes së Ofertave: 09.11.2020
4. Njoftimi për dhënie të kontratës/vendimi i AK : 10.12.2020
5. Njoftimi për eliminim: 10.12.2020
6. Kërkesa për Rishqyrtim – 15.12.2020
7. Vendimi i AK për Refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim: 16.12.2020
8. Dëshmitë : Referencat e kompanisë
9. Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se;

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*